



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, al. 1, pika “b” të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, al.1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2004 merr

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONEVE TË PÛRKOHSHME PËR TERRENE**  
**SPORTIVE NË LAGJET “DARDANIA” DHE “KODRA E DIELLIT” NË**  
**PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacioneve të përkohshme për terrene sportive në lagjet “Dardania” dhe “Kodra e Diellit” në Prishtinë.

**Neni 2**

Për ndërtimin e terreneve sportive në lagjen “Dardania” caktohet hapësira e evidencuar në pjesët e ngastrave kadastrale nr. 7553, 7554, 7561, 7477/1, 7768 , 7779, si lokacion nr. 1, dhe ngastrat kadastrale nr. 7558, 7590, 7591 si lokacion nr. 2, Zona kadastrale e Prishtinës.

Për ndërtimin e terreneve sportive në lagjen “Kodra e Diellit” caktohet hapësira e evidencuar në pjesët e ngastrave kadastrale nr. 2680, 2681, 2682 , 3001 si lokacion nr. 1, pjesët e ngastrave kadastrale nr. 2650, 2652, si lokacion nr. 2 dhe pjesët e ngastrave kadastrale nr. 2682, 2683, 2684, Zona kadastrale e Prishtinës.

**Neni 3**

Dhënia në shfrytëzim e lokacioneve si në nenin I të këtij Vendimi do të bëhet sipas procedurës së paraparë në Statutin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës

**Neni 4**

Sipërfaqja e nevojshme për ndërtimin e terreneve sportive, nga neni 2 i këtij Vendimi, do të përcaktohet në bazë të programeve dhe detyrave projektuese për realizim.

**Neni 5**

Lokacionet, nga neni 2 i këtij Vendimi, kanë karakterin e përkohshëm deri në miratimin e planeve rregullative për lagjet ku gjenden këto lokacione.

#### **Neni 6**

Me miratimin e planeve rregullative të lagjeve në të cilat caktohen lokacionet sipas këtij Vendimi, lokacionet të cilat nuk mund të inkorporohen në ato plane do të kthehen në gjendjen sipas destinimit të planifikuar me ato plane.

#### **Neni 7**

Kushtet e ndërtimit të përkohshëm të terreneve sportive në lokacionet e caktuara sipas këtij Vendimi, do të caktohen me lejen përkatëse urbanistike.

#### **Neni 8**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës dhe do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

#### **Neni 9**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe situacioni grafik i lokacioneve të përmendura, të përshkruara me nenin 2 të këtij Vendimi.

#### **Neni 10**

Me miratimin e planeve rregullative për lagjet në të cilat gjinden lokacionet e caktuara sipas këtij Vendimi, do të shfuqizohet ky Vendim.

#### **Neni 11**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01. NR. 031-3378 DT.07.12.2004**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**